



Opština Novo Brdo
Komuna e Novobërdës
Municipality of Novo Brdo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br <u>02/23</u>
Më/Dana: <u>13.01.2025</u>
NOVOBËRDË - NOVO BRDO

Bazuar në Memorandumin e nënshkruar të Mirëkuptimit për projektin e banesave adekuate sociale në mes të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Novobërdës, Komuna e Novobërdës njofton:

THIRRJE PUBLIKE

PËR DORËZIM KËRKESA PËR RINDËRTIM OSE RINOVIM TË SHTËPIVE PRIVATE PËR FAMILJE TË CËNUSHME

Kjo thirrje publike ka për qëllim të ofrojë mbështetje financiare dhe materiale për rindërtimin e shtëpive për familjet apo individët të cilët për shkaqe sociale dhe ekonomike jetojnë në kushte të vështira që jetojnë në territorin e komunës së Novobërdës.

Kriteret për mbështetje për rindërtimin e shtëpive që kanë nevojë për ndihmë janë:

1. *Se janë me vendbanim në territorin e komunës së Novobërdës dhe se posedojnë dokument identifikimi që vërteton këtë,*

Dokumentacioni i nevojshëm për dorëzim:

1. Aplikacioni/kërkesa e plotësuar me të gjitha të dhënat dhe e nënshkruar nga aplikanti;
2. Kopje e letërnjoftimit të aplikantit;
3. Deklaratë për bashkësinë familjare dhe numrin e anëtarëve të ekonomisë familjare;
4. Titulli që vërteton pronësinë e pronës;
5. Dëshmi e përdorimit të ndihmës sociale

Informacione shtesë:

Përparësi duhet t'u jepet kategorive të mëposhtme në kushte të barabarta:

1. Përfitues potencial ose familjar me nevoja të veçanta;
2. Përfitues të mundshëm me familjarë në gjendje të rëndë shëndetësore;
3. Përfituesit e mundshëm që nuk janë të punësuar dhe jo përfitues të një skeme sociale;
4. Prindër të vetëm;
5. Numri i anëtarëve të familjes

Shënim:

Përfitues do të jenë individët që renditen me numrin më të lartë të pikëve nga komisioni vlerësues, në varësi të kufizimeve buxhetore të planifikuara. Të gjithë përfituesit janë të detyruar të përdorin ndihmën e marrë për këtë qëllim.

Afati i dorëzimit:

Aplikantët të cilët dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të shprehin interesimin e tyre duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin në kopje fizike në Qendrën për Shërbimin e Qytetarëve të Komunës së Novobërdës nga ora 08:00 deri në ora 14:00.

Thirrja do të jetë e hapur nga data 13.01.2025 deri më 13.02.2025. , deri në orën 14:00,

Aplikimet pas këtij afati nuk do të pranohen.

Aplikimet e dorëzuara në formë fizike duhet të mbyllen në një zarf të mbyllur, dhe të shkuajn:

- Emri dhe mbiemri i aplikantit;
- Titulli i thirrjes publike;
- Data e aplikimit

Në Novobërdë,
Data: 13.01.2025.

Kryetari i komunës së Novobërdës
z.Saša Milošević

